



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 14 shtator 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesat për Ndryshimin e Afateve dhe

**Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Tretë mbi Ecurinë e Çështjes dhe
për Paraqitjen e Parashtrimeve**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit

Zhan-Lui Zhilisen

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ bazuar në nenet 21(6) dhe 39(1) dhe (13) të Ligjit Nr. 05/L-053 mbi Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 9(5)(a), 76, dhe 95(2)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim dhe urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, pas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,² Prokurori i Specializuar dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.³
2. Më 16 mars 2021, pas vendimit dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,⁴ Pjetër Shala ("z. Shala") u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës ("Belgjikë").⁵
3. Më 15 prill 2021, pas përfundimit të procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") në Hagë, Holandë.⁶

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 6 maj 2021, F00007/RED.

³ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe shtojcën 2, konfidenciale. Versioni konfidencial me më pak redaktime dhe versioni publik i redaktuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzuan më 31 mars 2021, F00016/A01 dhe F00016/A02.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u nxor më 6 maj 2021, F00008/RED. F00008/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për z. Pjetër Shala*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u nxor më 15 prill 2021, F00008/A01/RED.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

⁶ KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit*, 15 prill 2021, konfidencial, para. 2, me shtojcat 1-2, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u nxor më 26 prill 2021, F00019/RED.

4. Më 30 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të Lidhura me Të (“Vendimi Kornizë”).⁷
5. Më 21 qershor 2021, u mbajt konferenca e dytë mbi ecurinë e çështjes.⁸
6. Më 31 korrik 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) i dorëzoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake një njoftim lidhur me nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102(1)(b) për Mbrojtjen e z. Shala (“Mbrojtja”), dhe kërkoi në vijim shtyrjen e plotësimin të detyrimit për nxjerrjen e disa materialeve (“Kërkesa për Shtyrje”).⁹
7. Më 3 shtator 2021, ZPS-ja dorëzoi njoftimin e saj në bazë të rregullës 102(3) të Rregullores (“Njoftimi i Rregullës 102(3)”), me anë të të cilit, ndër të tjera, bëri me dije se ky njoftim do të plotësohej në kohën e duhur, përfshirë dhe në varësi të lejeve shtesë që ZPS-ja do të sigurojë lidhur me një numër materialesh të cilat nuk mund të përfshihen në listë aktualisht për shkak të kufizimeve që rrjedhin nga rregulla 107 e Rregullores.¹⁰
8. Më 9 shtator 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e miratoi Kërkesën për Shtyrje (“Vendimi për Shtyrje”).¹¹
9. Më 9 shtator 2021, Mbrojtja i kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake të shtyhej afati brenda të cilit ajo duhej t’i bënte me dije ZPS-së se cilat janë materialet e njoftimit

⁷ KSC-BC-2020-04, F00033, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të Lidhura me Të, 30 prill 2021, publik.

⁸ KSC-BC-2020-04, F00041, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Dytë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 7 qershor 2021 (“Urdhri i 7 qershorit 2021”), publik; KSC-BC-2020-04, Transkripti, 21 qershor 2021 (“Transkripti i 21 qershorit 2021”), publik.

⁹ KSC-BC-2020-04, F00057, Prokurori i Specializuar, *Njoftim për Gjykatësin e Procedurës Paraprake në lidhje me Nxjerrjen e Materialeve sipas Rregullës 102(1)(b) dhe Kërkesë për Shtyrje të Kufizuar të Afatit lidhur me Detyrimin për Nxjerrjen e Provave të Caktuara*, 31 korrik 2021 (njoftuar më 2 gusht 2021), rreptësisht konfidencial dhe ex parte. Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 4 gusht 2021, F00057/CONF/RED.

¹⁰ KSC-BC-2020-04, F00069, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3) me Shtoncën Konfidenciale 1*, 3 shtator 2021 (njoftuar më 6 shtator 2021), publik, me një shtojcë, KSC-BC-2020-04/F00069/A01, konfidencial.

¹¹ KSC-BC-2020-04, F00072, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Përmbledhës mbi Kërkesën e Shtyrje për Masa Mbrojtëse dhe Kërkesën për Shtyrje të Afatit në lidhje me Detyrimet për Nxjerrjen e Materialeve*, 9 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe ex parte. Versioni i redaktuar konfidencial u nxor më të njëjtën ditë, F00072/CONF/RED.

sipas rregullës 102(3) që të nxirren apo të ketë qasje në to, konkretisht nga 17 shtatori 2021¹² deri më 15 tetor 2021 (“Kërkesa e Mbrojtjes”).¹³

10. Më 10 shtator 2021, ZPS-ja iu përgjigj Kërkesës së Mbrojtjes dhe në vijim i kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake të ndryshonte disa afate të ndërlidhura (“Kërkesa e ZPS-së”).¹⁴ Mbrojtja dha përgjigje të njëjtën ditë (“Përgjigjja e Mbrojtjes”).¹⁵

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Në bazë të nenit 21(6) të Ligjit, të gjitha provat ose faktet materiale dhe relevante që i posedon ZPS-ja të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit vihen në dispozicion të të akuzuarit para fillimit të procedurës dhe gjatë saj, dhe i nënshtrohen vetëm atyre kufizimeve që janë rreptësisht të nevojshme dhe atëherë kur zbatohen mbrojtjet e nevojshme kundërbalancuese.

12. Në bazë të rregullës 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *proprio motu* ose nëse i tregohen arsye të vlefshme, mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara nga Rregullorja ose paneli.

13. Në bazë të rregullës 76 të Rregullores, kërkesa për zgjatje të afatit paraqitet në kohë për t'i lënë panelit kohë të mjaftueshme për marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën para përfundimit të afatit përkatës.

14. Në bazë të rregullës 95(2)(b) të Rregullores, pas paraqitjes së parë të të akuzuarit sipas rregullës 92 të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcakton afate për

¹² Vendimi Kornizë, para. 92(e).

¹³ KSC-BC-2020-04, F00074, Mbrojtësi i Specializuar, *Mocion i Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit të Kërkesës së saj sipas Rregullës 102(2) [sic]*, 9 shtator 2021, konfidenciale, para. 5, 8. Ndërkohë që Mbrojtja i referohet rregullës 102(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se Mbrojtja kërkon ndryshimin e afatit për kërkesën për ZPS-në sipas rregullës 102(3) të Rregullores.

¹⁴ KSC-BC-2020-04, F00076, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë për KSC-BC-2020-04/F00074 dhe Kërkesë për Modifikimin e Afateve të lidhura me të*, 10 shtator 2021, konfidenciale.

¹⁵ KSC-BC-2020-04, F00077, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Modifikimin e Afateve*, 10 shtator 2021, njoftuar më 13 shtator 2021), konfidenciale.

nxjerrjen e provave, merr masa për të mundësuar nxjerrjen në kohë, dhe përgatit një raport për trupin gjykues mbi nxjerrjen e materialeve.

III. DISKUTIM

A. KËRKESA E MBROJTJES

15. Mbrojtja parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme për ndryshimin e afatit brenda të cilit ajo duhet t'i bëjë kërkesë ZPS-së sipas rregullës 102(3) të Rregullores me qëllim që: (i) të mund të përparojë me shqyrtimin e materialeve të nxjerra për të kuptuar në tërësi çështjen kundër z. Shala; (ii) të përfundojë analizën e plotë të materialeve të identifikuara në njoftimin e ZPS-së sipas rregullës 102(2) [si në origjinal] dhe aktivitetet e tjera kërkimore të lidhura me to; dhe (iii) të marrë materialet e nxjerra në varësi të Vendimit mbi Shtyrjen e Nxjerrjes si dhe njoftimit shtesë të ZPS-së sipas rregullës 102(2) [si në origjinal].¹⁶ ZPS-ja përgjigjet se nuk e kundërshton shtyrjen e kërkuar pasi ajo do t'i mundësojë më tej Mbrojtjes të shqyrtojë materialet dhe të bëjë kërkesa të fokusuara në mënyrë më efikase.¹⁷

16. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se është demonstruar se ekzistojnë arsye të vlefshme që përligjin ndryshimet e kërkuara, bazuar në faktin se Mbrojtja ende nuk ka marrë disa materiale për shkak se janë shtyrë detyrimet e ZPS-së për nxjerrjen e disa materialeve sipas rregullës 102(1)(b) dhe ZPS-ja bën me dije se njoftimi i saj sipas rregullës 102(3) do të plotësohet në momentin e duhur. Për më tepër, ZPS-ja nuk e kundërshton kërkesën për shtyrje. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Kërkesa e Mbrojtjes është bërë në kohë të mjaftueshme para përfundimit të afatit në fjalë, konkretisht rreth një javë para afatit fillestar brenda të cilit Mbrojtja duhet t'i bëjë kërkesë ZPS-së sipas rregullës 102(3) të Rregullores. Për rrjedhojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e autorizon Mbrojtjen t'i bëjë kërkesë ZPS-së jo më

¹⁶ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 6.

¹⁷ Kërkesa e ZPS-së, para. 1-2.

vonë se 15 tetori 2021, për materialet e Njoftimit të Rregullës 102(3) në të cilat kërkon të ketë qasje me anë të nxjerrjes ose këqyrjes.

17. Për më tepër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është bindur se nuk zbulohet informacion konfidencial dhe, për rrjedhojë, urdhëron Administratoren që Kërkesën e Mbrojtjes ta riklasifikojë si publike në përputhje me rregullën 82(5) të Rregullores.¹⁸

B. KËRKESA E ZPS-SË

18. ZPS-ja pohon se ekzistojnë arsye të vlefshme për të ndryshuar afatet që kanë të bëjnë me përzgjedhjen nga ana e Mbrojtjes të materialeve të rregullës 102(3) si dhe për përgatitjen e dosjes paraprake të saj dhe të tabelës së rregullës 109(c).¹⁹ Ajo parashtron se kërkohet më shumë kohë për të shqyrtuar përzgjedhjet e Mbrojtjes sipas rregullës 102(3), për t'u takuar me Mbrojtjen e për të diskutuar lidhur me ndonjë mosmarrëveshje mbi rëndësinë materiale me qëllim që të shmangen debatet ligjore të panevojshme, për të identifikuar materiale për të cilat mund të nevojiten masa mbrojtëse në kuadrin e kësaj çështjeje penale apo të ndonjë tjetre, për të bërë redaktimet e duhura (përfshirë redaktimet standarde), dhe për të analizuar e nxjerrë materialet e kërkuara.²⁰ Për sa i përket kërkesës së saj për shtyrjen e afatit të dorëzimit të dosjes paraprake, ZPS-ja argumenton se deri në fund të nëntorit ajo do të jetë e zënë me përgjigjet ndaj kërkesave të rregullës 102(3).²¹ Gjithashtu, ajo pohon se, nga përvoja në çështjet e tjera, procesi i lidhur me tabelën e rregullës 109(c) nuk mund të fillojë para përfundimit të dosjes paraprake dhe, për t'u bërë në mënyrën e duhur, ai kërkon të paktën dy javë punë.²² Bazuar në sa më sipër, ZPS-ja propozon afatet e mëposhtme: (i) 29 tetor 2021 (ose brenda dy javësh nga momenti që Mbrojtja bën kërkesë sipas rregullës 102(3)) – afati brenda të cilit ZPS-ja t'i drejtohet Gjykatësit të Procedurës

¹⁸ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 9.

¹⁹ Kërkesa e ZPS-së, para. 3.

²⁰ Kërkesa e ZPS-së, para. 4.

²¹ Kërkesa e ZPS-së, para. 6.

²² Kërkesa e ZPS-së, para. 6.

Paraprake në rast se vendos të kundërshtojë rëndësinë materiale të provave; (ii) 12 nëntor 2021 (ose brenda katër javësh nga momenti që Mbrojtja bën kërkesë sipas rregullës 102(3)) – afati brenda të cilit ZPS-ja t'i nxjerrë Mbrojtjes ose ta lejojë atë të ketë qasje në materialet e përzgjedhura të cilat nuk kanë nevojë për redaktime; (iii) 26 nëntor 2021 (ose brenda gjashtë javësh nga momenti që Mbrojtja bën kërkesë sipas rregullës 102(3)) – afati brenda të cilit ZPS-ja të nxjerrë materialet që kanë nevojë për redaktime standarde, ose për të bërë kërkesë për redaktime jostandarde/masa mbrojtëse për materialet e përzgjedhura; (iv) 28 janar 2022 – afati brenda të cilit ZPS-ja të dorëzojë dosjen paraprake; dhe (v) 11 shkurt 2022 – afati brenda të cilit ZPS-ja të dorëzojë tabelën e rregullës 109(c).²³ Përgjigjja e Mbrojtjes është se nuk e kundërshton Kërkesën e ZPS-së pasi koha shtesë është shumë e rëndësishme për vetë atë për të përgatitur paraqitjen e provave.²⁴

19. Për sa i përket ndryshimeve të kërkuara të afateve brenda të cilave Mbrojtja duhet t'i bëjë kërkesë ZPS-së sipas rregullës 102(3) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se është demonstruar se ekzistojnë arsye të vlefshme që përlligjin ndryshimet e kërkuara bazuar mbi faktin se, krahas ndryshimit të sipërpërmendur që kërkon Mbrojtja, edhe ZPS-ja kërkon kohë shtesë për kryerjen e hapave proceduralë që rrjedhin nga rregulla 102(3) e Rregullores. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja nuk e kundërshton Kërkesën e ZPS-së dhe se ajo vetë kërkon kohë shtesë për t'u përgatitur për paraqitjen e provave të saj. Për më tepër, Kërkesa e ZPS-së është dorëzuar në kohë të mjaftueshme para përfundimit të afatit në fjalë, konkretisht rreth një javë para afatit fillestar brenda të cilit Mbrojtja duhet t'i bëjë kërkesë ZPS-së sipas rregullës 102(3) të Rregullores. Për rrjedhojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e autorizon ZPS-në: (i) t'i drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake në rast se kundërshton ligjërisht rëndësinë materiale të provave jo më vonë se 29 tetori 2021 (ose brenda dy javësh nga momenti që Mbrojtja bën kërkesë sipas

²³ Kërkesa e ZPS-së. 5.

²⁴ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 2.

rregullës 102(3)); (ii) t'i nxjerrë Mbrojtjes ose ta lejojë atë të ketë qasje në materiale të përzgjedhura të cilat nuk kanë nevojë për redaktime jo më vonë se 12 nëntori 2021 (ose brenda katër javësh nga momenti që Mbrojtja bën kërkesë sipas rregullës 102(3)); dhe (iii) të nxjerrë materiale të cilat kanë nevojë për redaktime standarde, ose të bëjë kërkesë për redaktime jostandarde/masa mbrojtëse për materiale të përzgjedhura jo më vonë se 26 nëntori 2021 (ose brenda gjashtë javësh nga momenti i kërkesës së Mbrojtjes sipas rregullës 102(3)).

20. Për sa i përket kërkesës për shtyrjen e afatit të dorëzimit nga ZPS-ja të dosjes paraprake dhe tabelës së rregullës 109(c), Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se, bazuar në nenin 39(1) të Ligjit, ai ka detyrim të pavarur për të garantuar që çështja të përgatitet siç duhet dhe në mënyrë të shpejtë për gjykim, ku përfshihet shmangia e vonesave të panevojshme. Kujtohet gjithashtu se afati aktual për dorëzimin e dosjes paraprake nga ana e ZPS-së, 19 nëntori 2021, është propozuar nga vetë ZPS-ja.²⁵ Afati i ri që propozon ZPS-ja, 28 janari 2022, përbën një zgjatje prej më shumë se dy muajsh. Për rrjedhojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e mendon të arsyeshme ta shtyjë vendimin e tij lidhur me këto aspekte të Kërkesës së ZPS-së me qëllim që të marrë hollësi të mëtejshme gjatë konferencës së ardhshme mbi ecurinë e çështjes lidhur me arsyet që justifikojnë ndryshimet e kërkuara.

21. Për më tepër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është bindur se nuk zbulohet informacion konfidencial dhe, për rrjedhojë, urdhëron Administratoren që Kërkesën e ZPS-së ta riklasifikojë si publike në përputhje me rregullën 82(5) të Rregullores.²⁶ Për të garantuar përputhshmërinë, Administratorja duhet të riklasifikojë edhe Përgjigjen e Mbrojtjes, e cila nuk përmban informacione konfidenciale, si publike. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e mendon të arsyeshme ta urdhërojë ZPS-në që të dorëzojë një version të redaktuar publik të Kërkesës për Shtyrje ose të tregojë nëse

²⁵ KSC-BC-2020-04, F00046, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Konferencën e Dytë mbi Ecurinë e Çështjes* ("Parashtrimet e ZPS-së për Konferencën e Dytë mbi Ecurinë e Çështjes"), 16 qershor 2021, publik, para. 8; Transkripti i 21 qershorit 2021, p. 53, rreshtat 6-17.

²⁶ Kërkesa e ZPS-së, para. 9.

versioni i redaktuar konfidencial i këtij parashtrimi mund të riklasifikohet si publik pa bërë redaktime të mëtejshme.

C. URDHËR PËR CAKTIMIN E DATËS SË KONFERENCËS SË TRETË MBI ECURINË E ÇËSHTJES DHE PËR PARAQITJEN E PARASHTRIMEVE

22. Pasi ka shqyrtuar mendimet e paraqitura nga palët lidhur me datën e konferencës së tretë mbi ecurinë e çështjes aktuale,²⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh konferencën e tretë mbi ecurinë e çështjes të enjten, 23 shtator 2021, në orën 09:00.

23. Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'u kërkojë palëve të japin përditësime, nëse ka, lidhur me çështjet e pazgjdhura nga rendi i ditës së konferencës së dytë mbi ecurinë e çështjes,²⁸ si dhe parashtrimet e tyre me shkrim e me gojë lidhur me ato çështje.²⁹ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të kërkojë përditësime nga palët dhe/ose pjesëmarrësit lidhur me pyetjet e mëposhtme:

(1) Nxjerrja e materialeve

(a) Kur do t'i përmbushë ZPS-ja detyrimet e shtyra të saj për nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102(1)(b) bazuar mbi Vendimin për Shtyrje;

(b) Cilat janë arsyt që e detyrojnë ZPS-në të plotësojë njoftimin e saj të rregullës 102(3) përveç nevojës së sigurimit të lejeve lidhur me kufizimet sipas rregullës 107 të Rregullores, dhe kur do t'i sigurojë ZPS-ja lejet sipas rregullës 107 të Rregullores me qëllim që të plotësojë njoftimin e saj të rregullës 102(3);

²⁷ Transkripti i 21 qershorit 2021, p. 64, rreshti 22 – p. 66, rreshti 8.

²⁸ Urdhri i 7 qershorit 2021, para. 11.

²⁹ Parashtrimet e ZPS-së për Konferencën e Dytë mbi Ecurinë e Çështjes; KSC-BC-2020-04, F00049, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrime në Vijim të Urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake të datës 7 qershor 2021 lidhur me Konferencën e Dytë mbi Ecurinë e Çështjes*, 17 qershor 2021, publik.

- (c) A ka ZPS-ja në posedim, kontroll apo dijeni faktike lidhur me prova shfajësuese të cilat mbeten për t'u nxjerrë për Mbrojtjen sipas rregullës 103 të Rregullores;
- (d) A ka identifikuar ZPS-ja ndonjë material tjetër i cili duhet t'u nënshtrohet kufizimeve sipas rregullës 107 të Rregullores;
- (e) A parashikon ZPS-ja të paraqesë ndonjë kërkesë për masa mbrojtëse, përfshirë lidhur me ndonjë kërkesë të Mbrojtjes për nxjerrjen ose këqyrjen e materialeve sipas rregullës 102(3) të Rregullores dhe/ose materialeve të cilat duhet të nxirren sipas rregullës 103 të Rregullores; dhe
- (f) A kanë hasur apo parashikojnë ndonjë vështirësi palët për sa i përket procesit të nxjerrjes siç është formuluar në Vendimin Kornizë.

(2) Përkthimet

- (a) A mund të vlerësojë ZPS-ja se cili është afati për përfundimin e përkthimit në shqip të disa deklaratave të mëparshme të dëshmitarëve siç kërkohet në Vendimin për Shtyrje; dhe
- (b) A kanë bërë ndonjë kërkesë palët se konkretisht cilat parashtrime ose materiale provash duhet të kenë përparësi për përkthim.

(3) Hetimet e ZPS-së dhe hapat e ardhshëm

- (a) A kanë përfunduar hapat e mbetur nga hetimet e ZPS-së, ose a mund të vlerësojë ZPS-ja se cila mendon se është data e përfundimit të tyre; dhe
- (b) Cilat janë arsyet konkrete që justifikojnë kërkesën e ZPS-së për shtyrjen e afatit të dorëzimit të dosjes së saj paraprake dhe të tabelës së rregullës 109(c) dhe a mendon ZPS-ja se shtyrjet e afatit mund të jenë më të kufizuara.

(4) Hetimet e Mbrojtjes dhe hapat e ardhshëm

(a) Bazuar mbi parashikimet e ZPS-së dhe procesin në vazhdimësi të nxjerrjes së materialeve (që do të vazhdojë deri të paktën në nëntor 2021), a mund të japë Mbrojtja informacion të mëtejshëm lidhur me ecurinë e hetimeve të saj, ndonjë synim për të bërë kërkesë lidhur me mundësitë hetimore unike sipas rregullës 99(1) të Rregullores, dhe afatin që mendon se i duhet për të përfunduar hetimet e saj;

(b) A mund të japë Mbrojtja informacion të mëtejshëm nëse synon të japë njoftim lidhur me shfrytëzimin e alibisë ose ndonjë arsyeje tjetër për përjashtimin e përgjegjësisë penale sipas rregullës 95(5) të Rregullores dhe ndonjë nxjerrje tjetër materialeve të lidhur me to sipas rregullës 104(1) dhe (2) të Rregullores; dhe

(c) A parashikon Mbrojtja të dorëzojë dosje paraprake dhe materialin përkatës sipas rregullës 95(5) të Rregullores dhe, nëse po, kur mendon se do të jetë në gjendje ta dorëzojë një parashtrim të tillë.

(5) Pikat e pajtimit mbi aspekte juridike dhe faktike

(a) A kanë filluar diskutimin palët lidhur me mundësinë e dorëzimit të pikave juridike dhe/ose faktike për të cilat ato pajtohen sipas rregullës 95(3) dhe 156 të Rregullores; dhe

(b) Kur mendojnë palët se mund të jenë në gjendje të identifikojnë një listë të pikave për të cilat ka kundërshtime dhe një listë të pikave për të cilat nuk ka kundërshtime.

(6) Kushtet e paraburgimit

(a) A mund të japë përditësime Administratorja lidhur me kushtet e paraburgimit, përfshirë, por jo vetëm, rregullat e vizitave nga ana e mbrojtësve dhe familjarëve.

24. Si përfundim, duke marrë parasysh disponueshmërinë e sallës së gjyqit gjatë javëve në vazhdim, palëve do t'u kërkohet të bëjnë të hënën, 15 nëntor 2021, nëse janë të disponueshëm për konferencën tjetër mbi ecurinë e kësaj çështjeje.

25. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në dhe Mbrojtjen të dorëzojnë parashtrime me shkrim lidhur me aspektet e paraqitura në paragrafët 20 dhe/ose 23 të këtij urdhri (sipas rastit), si dhe mbi temat e diskutuara gjatë konferencës së dytë mbi ecurinë e çështjes, ndonjë pikë tjetër të papërfshirë në rendin e ditës së konferencës së dytë apo të tretë mbi ecurinë e çështjes, ndonjë vështirësi për nxjerrjen e materialeve provuese, apo ndonjë pikë tjetër të ndërlidhur jo më vonë se përkatësisht të premtën, 17 shtator 2021 dhe të hënën, 20 shtator 2021.

VENDIM

26. Për arsyet e sipërpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

(a) **MIRATON** Kërkesën e Mbrojtjes dhe **URDHËRON** Mbrojtjen t'i bëjë me dije ZPS-së se në cilat materiale nga Njoftimi i Rregullës 102(3) dëshiron të ketë qasje me anë të procesit të nxjerrjes ose të këqyrjes jo më vonë se **të premtën, 15 tetor 2021;**

(b) **MIRATON** atë pjesë të Kërkesës së ZPS-së që ka të bëjë me ndryshimet e kërkuara të afateve që kanë lidhje me kërkesën e Mbrojtjes sipas rregullës 102(3) të Rregullores dhe **URDHËRON** ZPS-në: (i) t'i drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake në rast se kundërshton rëndësinë materiale të provave

bazuar mbi kërkesën e Mbrojtjes sipas rregullës 102(3) jo më vonë se **të premten, 29 tetor 2021** (ose brenda dy javësh nga momenti që Mbrojtja bën kërkesë sipas rregullës 102(3)); (ii) t'i nxjerrë ose ta lejojë Mbrojtjen të ketë qasje në materialet e përzgjedhura që nuk kanë nevojë për redaktime jo më vonë se **të premten, 12 nëntor 2021** (ose brenda katër javësh nga momenti që Mbrojtja bën kërkesë sipas rregullës 102(3)); dhe (iii) të nxjerrë materialet që kanë nevojë për redaktime standarde ose të bëjë kërkesë për redaktime jostandarde/masa mbrojtëse për materialet e përzgjedhura jo më vonë se **të premten, 26 nëntor 2021** (ose brenda gjashtë javësh nga momenti që Mbrojtja bën kërkesë sipas rregullës 102(3));

(c) **VENDOS** ta shtyjë vendimin e tij lidhur me pjesën e Kërkesës së ZPS-së që ka të bëjë me ndryshimet e kërkuar të afateve për dorëzimin e dosjes paraprake dhe tabelës së rregullës 109(c) të ZPS-së;

(d) **VENDOS** të mbledhë konferencën e tretë mbi ecurinë e çështjes me praninë e ZPS-së dhe Mbrojtjes, **të enjten, 23 shtator 2021, në orën 09:00**;

(e) **URDHËRON** ZPS-në dhe Mbrojtjen të dorëzojnë parashtrime me shkrim lidhur me aspektet e paraqitura në paragrafët 20, 23 dhe/ose 25 të urdhrin aktual (sipas rastit) përkatësisht deri **të premten, 17 shtator 2021 dhe të hënën, 20 shtator 2021**.

(f) **URDHËRON** Administratoren të riklasifikojë Kërkesën e Mbrojtjes (KSC-BC-2020-04/F00074), dhe Kërkesën e ZPS-së (KSC-BC-2020-04/F00076), dhe Përgjigjen e Mbrojtjes (KSC-BC-2020-04/F00077) si publike; dhe

(g) **URDHËRON** ZPS-në që të dorëzojë një version të redaktuar publik të Kërkesës për Shtyrje (KSC-BC-2020-04/F00057) ose të bëjë me dije nëse versioni i redaktuar konfidencial i këtij parashtrimi mund të riklasifikohet si publik pa redaktime shtesë jo më vonë se **të mërkurën, 22 shtator 2021**.

/nënshkrim/

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E enjte, 14 shtator 2021

Në Hagë, Holandë.